



2193/6
25-09-2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr.Regj.Them 1311
Dt.Regj 22.06.2015

Nr. 1167. Vendimi
Datë 14.09.2015

V E N D I M

“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

Gjyqtar- Astrit Shema

asistuar prej sekretares gjyqesore Anila Rista, në Vlore, sot më datë 14.09.2015 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqesore publike çështjen civile me Nr. **1311**. Regj.Them, date paraqitje 22.06.2015, që i përket paleve ndergjyqesore :

PADITES: Leonidha Qose,, I biri I Rodolf-it dhe I Tefta-s,, I dt.lindjes 31.07.1980, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, ruga "Hajredin Fratar", nr.1-Sauk tek ish-statcioni I fundit I autobuzave, klinika "3 yjet"-Sauk-Tirane, i perfaqesuar ne gjykim me procure te te posacme me Nr. 1124 rep e Nr. 449/2 kol date 25 Maj 2015, hartuar perpara noteres Alida Stamo-Tirane nga Avokat Shehebi Bifaku, me nr.lic.3263 dhe NIPT K 81304009G.,

TE PADITUR: 1.Drejtorja e Pergjithsheshme e Tatimeve (drejtorja e Apelimt)-Tirane, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim me nr.18670Prot, date 05.06.2015 leshuar prej Drejtores se Pergjithsheshme te tatimeve znj.Brisida Shehaj nga ana e juristes se Drejtorja Rajonale Tatimore Berat znj.Silvana Salla(Ne mungese ne shpallje te vendimit,prezenete gjate seancave te gjykimit)

2.Drejtorja Rajonale Tatimore Tirane (Ne mun gese)

3. Drejtorja Rajonale Tatimore Berat e perfaqesuar ne gjykim me autorizim te dates 09.07.2015 me nr.2193.Prot nga ana e juristes se Drejtorja Rajonale Tatimore Berat znj.Silvana Salla(Ne mungese ne shpallje te vendimit,prezenete gjate seancave te gjykimit)


OBJEKTI : -Shfuqzimin e Akt-Konstatimit nr. Serie 0439196 date 02.09.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane si nje akt relativisht i pavlevshem. --

-Shfuqzimi i procesverbalit gjobe me vlere 100 000 .leke per mospajisje fiskale, procesverballi gjobe per mosdeldarimin e te punesuarve ne vleren 250.000 leke, si procesverbaleve te mbajtura mbi nje Akt - Konstatimi relativisht te pavlefshem.

-Shfuqzimin e Njoftim Vlersimit per Detyrimet Tatimore Nr. 4346 prot date 18.11.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat.

-Shfuqzimin e Vendimit te Drejtorise se Apelimt Tatimore Nr. 31618/3 prot date 02.04.2015

Baza ligjore: Nenet 1,14,15/a,16,17/1/a 18,21,37 te ligjit nr.49 date 03.05.2012 "Per



RR 170 070 686 AA



Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative; Nenet 69,89,91,106,108,109,111,118,119,126,130 e te tjere te ligjit Nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" I ndryshuar; Nenet 118,119,122/2/a si dhe 135-146 te K.Pr.Administrative; Nenet 13-19 te Ligjit Nr.10279 date 20.05.2010 "Per Kundravajtet Administrative" .

Gjykata pasi mori provat e nevojeshme,degjoi ne kerkimet perfundimtare palet ne proces te cilat u shprehen respektivisht :

Paditësi kërkoi: Pranimin e padisë,

Perfaqesuesi i paleve te paditura : Rrezimin e padise;

si e analizoi çeshtjen ne teresine e saj :

VEREN :

Paditesi i është drejtuar kesaj gjykate, me padine e mesipercituar me objekt gjykimi te mesipercituar.

Gjykata, pasi studioi materialet e çështjes civile me Nr.1311.Akti , date 22.06.2015.Rregj te paraqitur per gjykim, ne baze te nenit 36 te K.Pr.Civile, ne te cilin parashikohet shprehimisht se: "Ne juridiksionin e Gjykatave hyjne te gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshje te tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te veçanta" si dhe ne reference dhe te nenit 7 te ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ne te cilin citohet se : " Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarrëveshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marrëdhëniet civile mes paleve ndergjyqese", çmoi kryesisht se çeshtja e paraqitur eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate.

Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligjit te mesipercituar "Kompetenca funksionale" ne te cilin citohet se : " 1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative,arriti ne kunkludimin se kjo çeshtje eshte nen kompetencen funksionale te kesaj gjykate.

Ne lidhje me kompetence tokesore kjo gjykate j'u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/20012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ne te cilin citohet se "1. Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.

Gjithashtu Gjykata, në vështrim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi çeshtje duhet gjykuar me nje gjyqtar te vetem.

Rezultoni se kjo çeshtje fillimisht është paraqitur prej pales paditese per kompetence gjykimi prane Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane dhe nga ajo gjykate me ane te vendimit me nr.3063,date 08.06.2015 është percjelle per kompetence tokesore prane Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore.

Rrethanat e çeshtjes

Subjekti Leonidha Qose, është regjistruar (ka filluar aktivitetin) prane Drejtorise Rajonale Tatimore Berat me date 09.01.2014, me Nipt L42509006M dhe me seli Lgj."Barrikada", Berat, me perfaqesues ligjior znj.Leonidha Qose dhe aktivitet privat Kopeshte,Çerdhe"

Ne baze te verifikimit ne sitemin informatik te DRT Berat dhe te ekstraktit historik te QKR-se te vet subjektit, u konstatua se subjekti me date 18.09.2014 ka hapur filial te veprimtaris se vete ne Tirane, me adrese sekondare : "Njesia Bashkiake nr.2, Rruga "Hajredin Fratar", godine 5-kateshe , kati I pare, zona kadastrale nr.2704 me nr.pasurie 217/07, me aktivitet. Kopesht Çerdhe "Tre Yjet".

Me ane te Njoftim-Vlersimit per detyrimet tatimore Nr.4346 prot.date 18.11.2014, subjektit i jane komunikuar gjobat ne vlere 100 000 leke (gjobe per mospajse me paisje fiskale) si dhe 250 000 leke (gjobe per mosdeklarim te te punesuarit)

Penalizimi Tatimor është rrjedhoje e vlersimit nga inspektori i Drejtorise se Perpunimit dhe Menaxhimit te te Ardhurave ne DRT Berat, ne baze te informacionit te derguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane , me ane te shkreses nr.71398/3 prot.date 13.10.2014 (protokolluar ne DRT Berat me nr.3482 prot.date 15.10.2014)me lende: Dergim Akt-Konstatimi dhe Proces-verbal Gjobe.

Inspektoret e Verifikimit ne Terren te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane ne baze te detyrave te tyre funksionale,kane mbajtur Akt-Konstatimin nr.serial 0439196 ku gabimisht ne vend te dates 02.10.2014 është shenuar date 02.09.2014 kjo e vertetuar edhe me Urdherin e Punes ne baze te te cilit është ushtruar kontroll i cili mban nr.71398 prot.date 30.09.2014, dhe Proces verbalin nr.0173251 date 02.10.2014.

Gjate kontrollit te ushtruar ne vendbiznes kane konstatuar se ne momentin e kontrollit ne vendbiznes u gjet znj.Tefta Qose pronarja e godines dhe e ema e Leonidhes.

Ne Akt-Konstatimi krahas te tjerave shprehet se: *"Ne vendbiznes akt-konstatimi u mbajt ne prani te znj.Tefta e cila na informoj qe ne aktivitet nuk dispononte kas fiskale. Ne nuk na u lejua te futeshim ne ambjentet e ketij biznesi".*

Ky Akt-Konstatim është firmosur nga vet znj.Tefta e cila ka gjithashtu ka shkruajtur se: *"Nuk mund te hyjne ne kopesht ne oren e mesimit kushdo qofshin ata, sqarimet mund te behen dhe jasht ambjentit te kopshtit.Tefta Qose"*

Ne baze te akt-konstatimit dhe process-verbalit te gjobes , subjekti është penalizuar me gjobe ne vleren 100 000 leke, bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 122 pika 1,germa "a", "i" ku shprehet se: *1-Tatimpaguesi person juridik ose fizik, tregetar, denohet ne rast se:*

a) nuk instalon paisjen fiskale per regjistrimin e pagesave me para ne dore:

l)hera e pare e konstatimit te mosinstalimit te paisjes fiskale , per te cilen është pecaktuar nje afat vendosjeje deri ne 10 dite pune, me gjobe ne masen 100 000 (njeqinde mije) leke.

Ne baze te verifikimit ne sitemin informatik te DRT Berat dhe te ekstraktit historik te QKR-se te vet subjektit, është konstatuar se subjekti me date 18.09.2014 ka hapur filial te

veprimtaris se vete ne Tirane dhe ne momentin e kontrollit subjekti ka qene I pa pajisur me paisje fiskale.

Gjithasht subject Leonidha Qose eshte penalizuar edhe me gjoben ne vlere 250 000 leke per modeklarim te te punesuarit, kjo per fakti se:

-personi qe eshte gjetur ne momentin e ushtrimit te kontrollit dhe qe ka firmosur Akt-Konstatimin ka qene znj.Tefta Qosja. Pasi jane bere verifikimet e metejshme ka rezultuar se znj.Tefata Qosja nuk eshte perfshire ne skemen e sigurimeve shoqerore, pra ka qene e padeklaruar prane ketij subjekti. Per kete arsye bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 119 "Mosdeklarim te te punesuarve" i ndryshuar, pika 1, germa b.

Ne zbatim te ligjit nr.9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e kontributeve te Detyrueshme te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore ne RSH-se" dhe referuar ne Kreun III "Format dhe procedurat e dorzimit te deklarave" germa "a", pika 2, e Udhezimit te Ministrit te Financave nr.26, date 16.04.2009, eshte percaktuar se:

"Pasqyrën e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna" E-SIG 027/a mund ta dërgojnë në drejtorinë rajonale tatimore me postë rekomande. Në këtë rast, dorëzimi konsiderohet brenda afatit kur data e postimit është të paktën 48 orë përpara fillimit të punës për çdo të punësuar rishtazi dhe për të larguarit nga puna brenda 10 ditëve...".

Nga verifikime ne sistemin Taxcrm rezulton qe kjo punonjese eshte e padeklaruar me ane te formularit E-SIG 027/a.

Ne momentin e kontrollit ka rezultuar se subject Leonidha Qose ka qene e papajisur me paisje fiskale dhe punonjesja znj.Tefta Qose e cila ka firmosur edhe akt-konstatimin ka qene e pa deklaruar ne organet tatimore.

Paditesi duke mos qene ne dakort me me masen administrative te mesipercituar ka ushtruar te drejten e ankimit prane Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjitheshme te tatimeve Tirane, fillimisht me kerkesen e dates 04.12.2014, kerkese per te cilen eshte urdheruar plotesimi I te dhenave prej Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjitheshme te tatimeve Tirane, dhe eshte trajtuar prej kesaj te fundit se bashku me kerkesen e bere me date 11.12.2014 dhe me vendimin e saj me nr.31618/3.Prot, date 02.04.2015 ka vendosur " Lenein ne fuqi te aktit object ankimi administrativ.

Ne rrethana te tilla pala paditese ka ushtruar te drejten e ankimit gjyqesor prane Gjykates Administrative duke pretenduar sipas aj persa me poshte vijon :

Pretendimet e pales paditese

-Pamvaresuisht se data e e hapjes se aktivitetit figuron 18.09.2014, faktikisht filiali I ketij aktiviteti (me nipt sekondar ne Sauk-Tirane) eshte 02.10.2014.

Nje dite pasi paditesi ka hapur aktivitetin me nipt sekondare ne Tirane ne objektin e tij privat, / konkretisht me date 2.10.2014 jane paraqitur prane subjektit tatimpagues Leonidha Qose dy persona te cilet kane komunikuar me nenen e tatimpaguesit Tefta Qose e cila nuk i ka lejuar te futen ne Objektin Kopesht-çerdhe per faktin se nuk jane prezamtuar si punonjes te tatimeve dhe ishte njeorar ku femijet ishin ne gjume ora 11.30.

Punonjesit e Tatimeve pa:u prezamtuar kane debatuar me nenen e Tatimpaguesit Tefta Qose e cila eshte shprehur se nuk ka, klease fiskale, por do.ta marrim se shpejti se dje e ka hapur djali.

-Informacioni qe dha nena e tatimpaguesit Tefta Qose, pa bere verifikimet brenda ku zhvillohej aiciviteti -Kopsht çerdhe, pa marre kontakt me tatimpaguesin apo perfaqesues ligjor te tij, Inspektoret Tatimore ne Sektorin e Verifikimit ne Teren prane DRT Tirane, ne kundershtim me nenet 33, 35, 63, J01 e etjer te ligjitnr 9920/2008 i ndryshuar kane mbajtur keto Akte-Administrative:

-Nga vete apa formale dhe permbajtja e Akt Konstatimit date 2.9.2014 eshte nje akt i pavlevshem pasi eshte marre, ne kundershtim ine ligjin material e procedural nr 9920/2008 konkretisht:

Akt-konstatimi nuk eshte mbajtur ne object.ku zhvillohej aiciviteti Kopsht Cerdhe, ne kundqrshim me nenin 33 te' ligjit 9920/2008 i ndryshuar ku urdherohet; *"Tatimpaguesi ka te drejte t'i sigurohen kontrolle te arsyeshme te cilat te kryhen ne kohen e arsyeshme , ne vendin e duhur dhe brenda afateve "*.

Akt-konstatimi sic shpjeguam me larte nuk eshte mbajtur ne vendin ku fishtionte aktivitetin tatimpaguesi e per pasoje nuk ka te pasqyruar rrethanat e faktit te kundrvatjes qe pretendohet, pretendime qe .ne seancen e kaluar nuk u mbeshteten me prova te tjera ngat te paditurit.

Akt-konstatimi nuk eshte mbajtur ne prani te tatimpaguesit (paditesit), akti eshte mbajtur pa e .lajmeraar ate, kjo ne kundershtim me nenet 35, 60, 63 e 101 te ligjit 9920/2008 i ndryshuar,ku urdherohet se :

-Nena e tatimpaguesit Tefta Qose e cila ka komunikuar me Inspektoret e Tatimeve, nuk eshte perfaqesuese e paditesit dhe nuk eshte as punonjese te subjekti qe eshte kontrolluar.

Tefta Qose ka qene te prona e-saj e cila banon ne katin e dyte te objektit dhe nuk ka lidhje me aktivitetin e djalit te ~~saj~~ ne,katin e pare te shtepise ~~se saj~~ Ry fakt I mos pasjes se perfaqesimit ligjore eshte konstaluar nga vete Inspektoret ku shprehen ne Akt konstatimi se *"Tefta Qose na tha seeshte perfaqesuese ligjore-por nuk na paraqiti karte identiteti"* si dhe nenkuptohet pasiTefta Qosei nuk ka paraqitur prove shkresore si perfaqesuese qe duhet ta kerkonin Inspektoret dhe mbi bazen e perfaqesimit te komunikonin me ~~zri~~ Tefta Qose. Inspektoret e Tatim nuk kane lene lajmerim per administratorin paditesin qe te merrte takim me ta si person pergjegjes per detyrimet tatimore.

-Sic theksuam dhe me ~~larte~~ paditesi nuk eshte lajmeruar qe te paraqitet te Tatimet ku te jepete te gj ithe-informational qe kerkonin Inspektoret ku do te pasqyroheshin rrethanat e faktit ne menyre reale dhe nuk do te rezultonin .me shkelje ligjore.

-Nisur sa siper ky akt eshte i pavlevshem per faktin se nuk eshte mbajtur me date 02.09.2014 dhe nuk eshle mbajtur ne prani te tatimpaguesit..dhe ne vendin e ushtrimit te aktivitetit, ~~ko~~ ne kundershtim dhe me nenet 13 e 14 te ligjit 10279/2010 "Per kundrvatjet administrative". Sqarojme gjykaten se ~~Zri~~ Tefta Qose eshte pronarja e shtepise dhe ka te drejte te jete e pranishme rreth prones se ~~saj~~ por nuk ka te drejte te jete te vendi ku zhvillohet aktiviteti nese eshte e ~~para regjistruar~~ e ~~da~~ nuk eshte punonjese dhe nuk ka perse te regjistrohet ne sigurime shoqerore.

Sipas rrethanave te paraqitura nga Inspektoret e Tatimcxe, ata kishin te drejte te linin lajmerim per paraqitje te administratorit ose te mbanin procesverbal per mos lejim te inspektoreve te kontrollonin subjektin ~~ko~~ bazuar ne : Ncni 101 Detyrimi per t'u paraqitur.

Ne seancen e kaluar perfaqesuesja e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, prapesoi se data e akt konstatimit eshte korrigjuar nga 2.9.2014 ne 2.10.2014. korrigjim qe eshte bere nga Drejtoria e Apelit Tatimor. Ky pretendim eshte i ;pa bazuar ne prova e ne ligj per faktin se ne kemi depozituar si prove shkresore Akt konstatimin e dates 2.9.2014 te pa korrigjuar dhe perfaqesuesja nuk depozitoi ne gjykate nje prove shkresore ku te jete bere korrigjimi nga Drejtoria e Apelit pamvarsisht se nuk ka te drejte ligjore te beje korrigjim. Korrigjimi behet sipas nenit 120, 128 e 129 te K.Pr.Administrative nga vete organi qe e ka leshuar dhe jo nga organi epror.

Paditesi se bashku me me Njoftimin per detyrimin Tatimor ka marre nje procesverbal Gjore i dates 02.10.2014 muaji i korrigjuar i cili eshte mbajtur ne baze te akt konstatimit te mesipem ku shprehet se " ;bazuar ne akt konstatimin nr 0439196 date 02.10.2014 (muaji i korrigjuar) subjekti i lartepemendur ushtron aktivitet i pa paisur me kase fiskale Nga ana jone u muar masa e penalitetit si me poshte pas verifikimit te bere ne system SIT"

Bazuar ne nenin 122 pika 1 germa a/i teligjit 9920 date 19.05.2008 ka vendosur te denoje me gjoben 100.000 leke.

Ashtu si Akt-Konstatimi dhe procesverbali. I mesiper eshte I pavlevshem pasi eshte mbajtur ne kundershitim. me ligjin. material, e procedural nr 9920/2008 dhe te ligjit te posacem nr 10279/2010, konkretisht:

- Proces-verbali nuk eshte mbajtur ,ne vend konstatimin e kundravatjes, pasqyron rrethana te pa verifikuara te subjekti. nuk eshte firmosur nga tatimpaguesi mbishkrimi refuzon dhe firmat poshte mbishkrimit refuzon jane te Inspektoreve dhe jo te tatimpaguesit, si dhe nuk eshte informuar per hartimin e procesverbajit, keto ne kundershitim me ligjin 10279/2010.

III.-DR e Tatimeve Berat pa, u bazuar ne akt konstatim apo ne procesverbal, por duke mjaftuar

vetem ne.faktin se shtetesja Tefta Qose ka refuzuar te nenshkruar akt konstatimin dhe nga verifikimi qe 'ka.bere ne system I ka konstajuar se nuk eshte e siguruar ka vendosur gjore ndaj Tatim paguesit ne masen 250.000 leke; per mos sigurim te saj si e punesuar.

-Ne masen gjobes nuk eshte marre aie konsiderate qe Tefta Qose nuk ka asnje lidhje me aktivitetin e kopesht-çerdhes,dhe fakti se.eshte nena-e tatimpaguesit nuk duhet te penalizohet per mos sigurim te saj pa verifikuar nese eshte 3e punesuar apo jo. DR e Tatimeve Berat I ka patur mundesite e verifikimit ku ne akt konstatim nuk eshte e cilesuar se kishte punonjes te pa sigurur dhe eshte cilesuar. se nuk eshte kontrolluar dhe Tefta eshte nena e tatimpaguesit.

Drejtoria e Apelit nevendimin e mesipem. duke mos marre ne konsiderate rrethanat e faktit te prezantuar nga paditesi ka.arsyetuar se;

-sipas te dhenave ne. QKR ju keni filluar aktivitetin ne date 18.09.2014 dhe ne momentin e kontrollit ju keni qene I pa paisur me kase fiskale.'

-nderkohe qe personin e gjetur,ne momentin e kontrollit I vetmi person I kontaktuar I cili dhe ka firmosur Akt - Konstatimin ka qene. Znj. Tefta Qose pasi jane bere verifikimet e nevojshnw Icq rezultuar se ka qene e padeklaraar, ...nga verifikimi ne sistemin Taxcrm rezulton kjopunonjese eshte e pa deklaruar me ane te formularit E-SIG 027/a.

-Njoftim vlersimi per detyrimin tatimor eshte i pa bazuar ne rrethanat e faktit ku pa u bazuar ne akt konsfatimin dhe ne procesverbal por vetem ne faktin se nena e tatimpaguesit nuk figuronte e regjistruar ne sigurime kane -aplikuar gjore ne raasen 250000 leke ku tatim paguesi ka te siguruar 6 Punonjes per aktivitetin e tij.

Drejtoriae Apelimit ne vendimin e saj ka gabuar duke pasqyruar nje fakt qe Inspektoret e

kane qartësuar qe nuk u lejuan te benim kontroll, nderkohe ne vendimin e Drejtorise Apelit arsytohet se nga kontrolli u verifikuar se paditesi nuk eshte pajisur me paisje fiskale dhe nuk kishte te regjistruar punonjesen Tefta Qose ne sigurime shoqerore.

Vendimi i Drejtorise se Apelit eshte i njeanshem dhe i bazuar ne akte te njeanshme ne akt konstatimin dhe procesverbaline organeve vartese te Tatimeve dhe nuk eshte bazuar ne prova te tjera duke mos i kthyer pergjigje apo arsye,tuar pretendimet e paditesit.

Persa me sioper kerkojme pranimin e padise sipas ob jekti te saj.

Prapesimet e pales se paditur

Ne baze te akt-konstatimit dhe process-verbalit te gjobes , subjekti eshte penalizuar me gjobe ne vleren 100 000 leke, bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 122 pika 1,germa "a","i" ku shprehet se:
1-Tatimpaguesi person juridik ose fizik, tregetar, denohet ne rast se:

a) nuk instalon paisjen fiskale per regjistrimin e pagesave me para ne dore:

1)hera e pare e konstatimit te mosinstalimit te paisjes fiskale , per te cilen eshte pecaktuar nje afat vendosjeje deri ne 10 dite pune, me gjobe ne masen 100 000 (njqinde mije) leke.

Detyrimin per te instaluar dhe perdorur paisjen fiskale, percaktohet ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 55 "Detyrimi per perdorimin e paisjes fiskale", Udhezimit nr.24, date 02.09.2008 ne zbatim te ketij ligji, Kreu VI, pika 55 dhe VKM-se nr.781,date 14.11.2007, ndryshuar me VKM-ne nr.1476,date 12.11.2008, ndryshuar me VKM-ne nr.1286,date 23.12.2009 dhe udhezimin nr.16,date 03.05.2008.

Gjithasht subject Leonidha Qose eshte penalizuar edhe me gjoben ne vlere 250 000 leke per modeklarim te te punesuarit, kjo per fakti se:

-personi qe eshte gjetur ne momentin e ushtrimit te kontrollit dhe qe ka firmosur Akt-Konstatimin ka qene znj.Tefta Qosja. Pasi jane bere verifikimet e metejshme ka rezultuar se znj.Tefata Qosja nuk eshte perfshire ne skemen e sigurimeve shoqerore, pra ka qene e padeklaruar prane ketij subjekti. Per kete arsye bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 119 "Mosdeklarim te te punesuarve" i ndryshuar, pika 1, germa b.

Ne zbatim te ligjit nr.9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e kontributeve te Detyrueshme te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore ne RSH-se" dhe referuar ne Kreun III "Format dhe procedurat e dorzimit te deklaratave " germa "a",pika 2,e Udhezimit te Ministrit te Financave nr.26,date 16.04.2009,eshte percaktuar se:

"Pasqyrën e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna" E-SIG 027/a mund ta dërgojnë në drejtorinë rajonale tatimore me postë rekomande. Në këtë rast, dorëzimi konsiderohet brenda afatit kur data e postimit është të paktën 48 orë përpara fillimit të punës për çdo të punësuar rishtazi dhe për të larguarit nga puna brenda 10 ditëve...".

Nga verifikime ne sistemin Taxcrm rezulton qe kjo punonjese eshte e padeklaruar me ane te formularit E-SIG 027/a

Ne piken 80.03 c) te Udhezimit nr.24, date 02.09.2008, ne zbatim te ligjit eshte percaktuar se:

“Verifikimet ne vend. Këto verifikime te shkurtra synojnë zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshëm (identifikimin e personave te paregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e ditës, te lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë se kontrollit për verifikime ne vend”.

Ne momentin e kontrollit ka rezultuar se subject Leonidha Qose ka qene e papajisur me paisje fiskale dhe punonjesja znj. Tefta Qose e cila ka firmosur edhe akt-konstatimin ka qene e pa deklaruar ne organet tatimore.

Legjislacioni I zbatueshem

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, parashikon se:

“Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Ky parashikim kushtetues është në të njëjtën linjë me neni 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore:

“Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar”.

Ndërkohë, gjykatat detyrohen edhe nga neni 44 i Kushtetutës, sipas të cilit:

“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Për sa më sipër, vendimi objekt shqyrtimi do të trajtohet nga gjykata si cdo akt administrativ. Në nenin 15 te igjit me nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikohet, se: Te drejten e padise e ka :a) cdo subject, qe pretendon se I eshte cenuar nje e drejte apo nje interes I ligjshem nga nje veprim apo mosveprim I organit public;

“Padia, sipas nenit 17 të këtij Ligji mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të

drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive..."

Në nenin 119 i Ligjit 9920/2009 "Per Procedurat Tatimore" parashikohet se :

Neni 119 **Mosdeklarimi i punonjësve** 1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh; b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh. (Ndryshuar me Ligj Nr. 124/2012, dt. 20.12.2012. Botuar ne Fl.z. nr. 177, dt. 09.01.2013). 2. Për rastet e konstatuara nga zyra të shkeljes së afatit të deklarimit të punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, tatimpaguesi dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo deklaratë të padorëzuar apo të dorëzuar jashtë afatit. 3. Tatimpaguesi duhet të deklarojë në organin tatimor të larguarit nga puna brenda 10 ditëve nga data e largimit. Për shkeljen e këtij afati, detyrimet vlerësohen deri në datën e deklarimit të tyre në organet tatimore. (Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011).

Udhezimi me nr.24, date 02.09.2008, i ndryshuar "Per procedurat tatimore"

119. Mosdeklarimi i të punësuarve

119.1 *Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta. Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklaram duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve. Në mbështetje të nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", punonjësit e administratës tatimore, të autorizuar me shkrim, kryejnë verifikime e kontrole në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklarimin e numrit të punonjësve. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar, që fillon punë për herë të parë te tatimpaguesi apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së të vetëpunësuarit me të cilët ai punon e bashkëjeton), përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të papaguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimpaguesi përkatës detyrohet të paguajë edhe një gjobë prej:*

a) 500 000 (pesëqind mijë) lekë kur është tatimpagues i regjistruar njëkohësisht për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi fitimin; dhe

b) 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo rast mosdeklarimi për të gjithë tatimpaguesit e tjerë që nuk përfshihen në shkronjën "a" të kësaj pike.

Zgjidhja ligjore

Gjykata ne lidhje me barren e proves per te provuar ligjshmerine e veprimeve apo mosveprimeve te organit administrativ, ka per reference nenin 35/1 te ligjit me nr. nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative” ne te cilin citohet se :”Organi i administrates publike ka detyrimin te provoje ligjshmerine e aktit administrativ, kontrates administrative dhe te veprimet tjeter administrativ te nxjerre jo me kerkese te paditesit si dhe te faktit qe ka parashtruar dhe ka vene ne themel te veprimtarise se kundershtruar ne gjykate”.

Gjithashtu, Gjykata, duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të K.Pr.C dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjore që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët.”, arrin në konkluzionin se padia duhet rrezua, për arsytet si më poshtë vijon:

Nga seanca gjyqesore rezultoi e provuar se subjekti Leonidha Qose, është regjistruar (ka filluar aktivitetin) pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat me date 09.01.2014, me Nipt L42509006M dhe me seli Lgj.”Barrkada”, Berat, me përfaqësues ligjor znj.Leonidha Qose dhe aktivitet privat Kopeshte,Çerdhe”

Ne baze te verifikimit ne sitemin informatik te DRT Berat dhe te ekstraktit historik te QKR-se te vet subjektit, u konstatua se subjekti me date 18.09.2014 ka hapur filial te veprimtaris se vete ne Tirane, me adrese sekondare : “Njesia Bashkiake nr.2, Rruga “Hajredin Fratari”, godine 5-kateshe , kati I pare, zona kadastrale nr.2704 me nr.pasurie 217/07, me aktivitet Kopesht Çerdhe “Tre Yjet”.

Me ane te Njoftim-Vlersimit per detyrimet tatimore Nr.4346 prot.date 18.11.2014, subjketit i jane komunikuar gjobat ne vlere 100 000 leke (gjobe per mospajse me paisje fiskale) si dhe 250 000 leke (gjobe per mosdeklarim te te punesuarit)

Penalizimi Tatimor eshte rrjedhoje e vlersimit nga inspektori i Drejtorise se Perpunimit dhe Menaxhimit te te Ardhurave ne DRT Berat, ne baze te informacionit te derguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane , me ane te shkreses nr.71398/3 prot.date 13.10.2014 (protokolluar ne DRT Berat me nr.3482 prot.date 15.10.2014)me lende: Dergim Akt-Konstatimi dhe Proces-verbal Gjobe.

Paditesi duke mos qene ne dakort me me masen administrative te mesipercituar ka ushtruar te drejten e ankimit pranë Drejtorisë se Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë se Pergjitheshme te tatimeve Tirane, fillimisht me kerkesen e dates 04.12.2014, kerkese per te cilen eshte urdheruar plotesimi I te dhenave prej Drejtorise se Apelimit Tatimor pranë Drejtorise se Pergjitheshme te tatimeve Tirane, dhe eshte trajtuar prej kesaj te fundit se bashku me kerkesen e bere me date 11.12.2014 dhe me vendimin e saj me nr.31618/3.Prot,date 02.04.2015 ka vendosur “ Lenein ne fuqi te aktit object ankimi administrativ.

Ne rrethana te tilla pala paditese ka ushtruar te drejten e ankimit gjyqesor pranë

Gjykates Administrative duke pretenduar sipas aj persa me poshte vijon :

1.Akt konstatimi I pales se paditur eshte I paligjshem pasi nuk eshte mbajtur ne vendim ku zhvillohet aktiviteti dhe per pasoja nuk ka pasyruar rrethanat e faktit,pasi gjithashtu ai nuk eshte mbajtur ne prani te tatimpaguesit.

Ne lidhje me kete pretendim ta pales paditese gjykata vlereson se ai eshte nje pretendim I pa baze,pasi ndodhemi perpara faktit se vete nena e paditesit tefta Qose e cila eshte ndodhur ne momentin qe inspektorët e tatimit do te realizonin kontrollin per verifikimin e pajisjes apo jot e paditesit qe zhvillonte aktivitet ne sherbimin tregatar” Kopesht-çerdhe” per femije ka pohuar se nuk dispononin kase fiskale.

Ne rrethana te tilla me te drejte punonjesit e tatimeve kane aplikuar dispozitat ligjore,ne baze te akt-konstatimit dhe process-verbalit te gjobes , subjekti eshte penalizuar me gjobe ne vleren 100 000 leke, bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar, neni 122 pika 1,germa “a”,”i” ku shprehet se:
1-Tatimpaguesi person juridik ose fizik, tregetar, denohet ne rast se:

a) nuk instalon paisjen fiskale per regjistrimin e pagesave me para ne dore:

I)hera e pare e konstatimit te mosinstalimit te paisjes fiskale , per te cilen eshte pecaktuar nje afat vendosjeje deri ne 10 dite pune, me gjobe ne masen 100 000 (njqinde mije) leke.

Detyrimin per te instaluar dhe perdorur paisjen fiskale, percaktohet ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar, neni 55 “Detyrimi per perdorimin e paisjes fiskale”, Udhezimit nr.24, date 02.09.2008 ne zbatim te ketij ligji, Kreu VI, pika 55 dhe VKM-se nr.781,date 14.11.2007, ndryshuar me VKM-ne nr.1476,date 12.11.2008, ndryshuar me VKM-ne nr.1286,date 23.12.2009 dhe udhezimin nr.16,date 03.05.2008.

Ne baze te verifikimit ne sitemin informatik te DRT Berat dhe te ekstraktit historik te QKR-se te vet subjektit, u konstatua se subjekti me date 18.09.2014 ka hapur filial te veprimtaris se vete ne Tirane dhe ne momentin e kontrollit subjekti ka qene I pa pajisur me paisje fiskale.

Per sa me siper, bazuar ne udhezimin nr.39, date 09.12.2008 “Per Administrimin dhe dokumentimin e e procedurave te paisjes fiskale” pika 4.17, ku theksohet se:

Inspektorët tatimor kryejne rregullisht kontrolle per leshimin e kuponave tatimore dhe mbajne process verbale kur konstatojne shkelje duke vendosur ne vend gjoben sipas percaktimeve ligjore, per tatimpaguesit dhe per klientet shkeles te ligjit.

Ne nenin 46 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 shprehet se:

1-Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim fitimit, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, **në përputhje me ligjet e fushës**, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

2.Pretendim I I pales paditese se akti administrativ per denimin e tij eshte I paligjshem pasi ai nuk pasyron te verteten ne lidhje me daten e pasyrimit te te akt-konstatimit sepse mban daten 02.09.20-14 dhe jo kur eshte kryer ne fakt 02.10.2014 eshte nje pretnim I pa bazuar ne ligj,pasi verteteohet qartesisht se kemi te bejme me nje gabim material ne lidhje me shenimin e dates ne ate akt ku ne vend qe te shenohej muaji 0 10-te (tetor) eshte shenuar muaji I 9-te (shtator).Eshtwe e plotesisht e verifikueshme se kemi te bejme me nje gabim te mundhsem njeresor ne shenimin e dates ne kete akt konstatimi pasi sikurse pranon edhe vete pala

paditese me date 02.09.2014 nuk kish filluar akoma aktiviteti tregatar I pales paditese dhe per rrjedhoje nuk kish sesi te ndodhemi ne rastin e perpilimit te aktit me date 02.09.2014. Jo çdo lloj agbimi mund te behet shkak per pavlefshmerine e nje akti nese ky gabim nuk ndikon ne vlefshmerine totale te pasyrimit te rrethanave ne ate akt.

Perderisa pala paditese nuk eshte pajisur me kase fiskale Brenda aftit ligjor te parashikuar nga ligji me te drejte pala e paditur ka aplikuar masen administrative te denimit te pales paditese ne perputhje me kriteret ligjore, bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 122 pika 1, germa "a", "i" ku shprehet se:

1-Tatimpaguesi person juridik ose fizik, tregetar, denohet ne rast se:

a) nuk instalon paisjen fiskale per regjistrimin e pagesave me para ne dore:

I)hera e pare e konstatimit te mosinstalimit te paisjes fiskale , per te cilen eshte pecaktuar nje afat vendosjeje deri ne 10 dite pune, me gjobe ne masen 100 000 (njqinde mije) leke.

2. Ne lidhje me pretendimin tjeetr te pales paditese se nuk duhej aplikuar masa e gjobes per palen paditese ne masen 250.000 leke pasi nuk kemi mosdeklarim punonjesi prej paditesit, gjykat e vlereson si nje kerkim I cili nuk eshte I bazuar ne ligj dhe ne prova.

Nese nena e paditesit nuk isht me cilesin e te punesuares ne ate aktivitet te djalit te saj nuk kish perse te ndodehj ne ate kohe ne vendin e punes dhe te moslejonte punonjesit e tatimeve per te hyre ne object me argumentin se femijet jane ne gjum. Nuk provohet prej pales paditese se ne object nodhej ndonje person tjeter I punesuar qe ushtronte detyrate e saj ne lidhje me kete lloj aktiviteti, pra qe do te thote qe ky lloj aktiviteti isht nen perkujdesjen dhe mbikqyrjen e nenes se paditesit dhe pamvaresisht se eshte familjare e ketij aktiviteti te paditesit, ajo patjeter duhej te deklarohet si e punesuar.

-Nena e paditesit e quajtur Tefta Qose eshte personi qe eshte gjetur ne momentin e ushtrimit te kontrollit dhe qe ka firmosur Akt-Konstatimin. Pasi jane bere verifikimet e metejshme ka rezultuar se znj. Tefata Qosja nuk eshte perfshire ne skemen e sigurimeve shoqerore, pra ka qene e padeklaruar prane ketij subjekti. Per kete arsye bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 119 "Mosdeklarim te te punesuarve" i ndryshuar, pika 1, germa b.

Ne zbatim te ligjit nr.9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e kontributeve te Detyrueshme te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore ne RSH-se" dhe referuar ne Kreun III "Format dhe procedurat e dorzimit te deklaratave " germa "a", pika 2, e Udhezimit te Ministrit te Financave nr.26, date 16.04.2009, eshte percaktuar se:

"Pasqyrën e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna" E-SIG 027/a mund ta dërgojnë në drejtorinë rajonale tatimore me postë rekomande. Në këtë rast, dorëzimi konsiderohet brenda afatit kur data e postimit është të paktën 48 orë përpara fillimit të punës për çdo të punësuar rishtazi dhe për të larguarit nga puna brenda 10 ditëve...".

Nga verifikime ne sistemin Taxcrm rezulton qe kjo punonjese eshte e padeklaruar me ane te formularit E-SIG 027/a

Ne piken 80.03 c) te Udhezimit nr.24, date 02.09.2008, ne zbatim te ligjit eshte percaktuar se:

"Verifikimet ne vend. Këto verifikime te shkurtra synojnë zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshëm (identifikimin e personave te paregjistruar),

me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës, të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend”.

Në nenin 119 i Ligjit 9920/2009 “Per Procedurat Tatimore” parashikohet se :

Neni 119 **Mosdeklarimi i punonjësve** 1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh; b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh. (Ndryshuar me Ligj Nr. 124/2012, dt. 20.12.2012. Botuar në Fl.z. nr. 177, dt. 09.01.2013). 2. Për rastet e konstatuara nga zyra të shkeljes së afatit të deklarimit të punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, tatimpaguesi dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo deklaratë të padorëzuar apo të dorëzuar jashtë afatit. 3. Tatimpaguesi duhet të deklarojë në organin tatimor të larguarit nga puna brenda 10 ditëve nga data e largimit. Për shkeljen e këtij afati, detyrimet vlerësohen deri në datën e deklarimit të tyre në organet tatimore. (Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar në Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011).

Udhëzimi me nr.24, date 02.09.2008, i ndryshuar "Per procedurat tatimore"

119. Mosdeklarimi i të punësuarve

119.1 Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta. Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë të subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklarim duhet të bëhet të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës së të punësuarve. Në mbështetje të nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, punonjësit e administratës tatimore, **të autorizuar me shkrim**, kryejnë verifikime e kontrole në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklarin e numrit të punonjësve. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar, që fillon punë për herë të parë të tatimpaguesi apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së të vetëpunësuarit me të cilët ai punon e bashkëjeton), përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të paguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimpaguesi përkatës detyrohet të paguajë edhe një gjobë prej:

a) 500 000 (pesëqind mijë) lekë kur është tatimpagues i regjistruar njëkohësisht për tatimin mbi

vlërën e shtuar dhe tatimin mbi fitimin; dhe
 b) 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo rast mosdeklarimi për të gjithë tatimpaguesit e tjerë që nuk përfshihen në shkronjën "a" të kësaj pike.

Sa me sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e paditësit është e pa mbështetur në ligj dhe në prova dhe, si rrjedhojë e ajo duhet rrezuar.

Meqenese kjo padi u rrezua nga ana e Gjykatës atehere, në mbështetje të nenit 106 të K.Pr.Civile taksa mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe për një avokat i ngarkohen inicuese të këtij gjykimi/paditese.

Vlen të theksohet se ku vendim në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative » duke qene se ndodhemi përpara faktit të kundërshtimit të një akti administrativ ku vlera e masës së kundërshtuar në këtë akt administrativ është me e vogël se rrethësia e pages minimale në shkallë vendi, vendimi i mesipercituar është i paankimueshem.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenin 126 dhe 310 të K.Pr.Civile dhe nenet 40, 42 të ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative »:

VENDOSI:

- Rrezimin e kërkesë padisë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës inicuese të këtij gjykimi..
- Ky vendim është i formës së prirë konform nenit 45 të ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative ».

U shpall në Vlore, sot më dt. 14.09.2015

SEKRETARE

Anila Rista



GJYQTARI

Astrit Shema



SHPENZIMET GJYQESDORE

Takse padie 3.000 leke

Takse njoftimi 200 leke

Shuma totale 3.200 leke

